

UDHËZIM Nr. 12, datë 28.4.2023

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 26, DATË 4.9.2008,
“PËR TAKSAT KOMBËTARE”, TË NDRYSHUAR**

Në zbatim të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në zbatim të ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar, ministri i Financave dhe Ekonomisë

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 26, datë 4.9.2008, “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar, fjalia e parë e germs “ii”, të paragrafit 2.8.6 të udhëzimit, ndryshohet me përmbajtjen, si më poshtë vijon:

“ii. Në llogaritjen e taksës për ambalazhin plastik, nga pesha bruto, do të zbritet pesha e paletave të drurit, paletave të kartonit dhe paletave metalike.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË

Delina Ibrahimaj

Botuar ne F.Zyrtare 72/2023

Dale nga shtypi me 04.05.2023